




QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Riintegrimi i luftëtarëve të huaj të rikthyer:

Çfarë qasje i përshtatet më së miri Kosovës?





QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Riintegrimi i luftëtarëve të huaj të rikthyer:

Çfarë qasje i përshtatet më së miri Kosovës?

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autore: Arife Muji

Rishikimi i brendshëm: Skender Perteshi dhe Florian Qehaja

Rishikimi i jashtëm: Shpend Kursani

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Te drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin nr. 04/L-065 mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ndërlidhura, si dhe Ligjin nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat të Ndërlidhura.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik ose tjetër, pa lejen paraprake të botuesit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyrojnë detyrimisht ato të partnerëve a të donatorëve të saj.

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
HYRJE.....	9
METODOLOGJIA	11
1. KONTEKSTI HISTORIK I LEDH NË KOSOVË.....	12
2. RËNDËSIA E PROGRAMEVE TË REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT NË LUFTIMIN DHE PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM	14
2.1. Rast studimor: Gjermania	16
2.2. Rast studimor: Danimarka	18
2.3. Rast studimor: Arabia Saudite.....	21
3. A MUND TA KRIJOJMË NJË MODEL KOSOVAR PËR T'U MARRË ME LH-TË?	25
3.1. Faza e rehabilitimit	26
3.2. Faza e riintegritimit.....	28
3.3. Faza pas burgimit.....	31
4. PËRFUNDIM.....	32
BIBLIOGRAFIA	33

LISTA E SHKURTESAVE

BIK	Bashkësia Islame e Kosovës
BKS	Barometri Kosovar i Sigurisë
BN	Bashkësia Ndërkombëtare
ÇSPT	Çregullimi i Stresit Pas Traumës
ISIL	Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit
ISIS	Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë
LEDh	Luftimi i Ekstremizmit të Dhunshëm
LH	Luftëtar i Huaj
OKB	Kombet e Bashkuara
PK	Policia e Kosovës
PPH	Program i Parandalimit të Hershëm
PRKM	Parandalimi Rehabilitimi dhe Kujdesi i Mëpastajme
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
QKR	Qendra e Kujdesit dhe Rehabilitimit
SKT	Strategjia Kundër Terrorizmit
ShDMI	Shërbimi Danez për Mbrojtje dhe Inteligjencë
Shi	Shteti Islamik
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Është e vështirë t'i qasesh me politika mosangazhimit dhe reintegrimit të ish-luftëtarëve të huaj në Kosovë pasi që ende nuk egziston një program bazë. Krahasuar me vende të tjera evropiane, kapacitetet institucionale për të hartuar dhe zbatuar programe të suksesshme riintegrimi janë tejet të kufizuara. Korniza e sotme ligjore, nëpërmjet sistemeve korrektuese dhe institucioneve të ngjashme, nuk jep zgjidhje të mjaftueshme meqë nuk përputhet me gjendjen në terren. Është një nevojë urgjente që Kosova duhet ta ndërtojë modelin vetanak duke u bazuar në kapacitetet lokale dhe kontekstin për raste specifike, por një program i detajuar risocializimi dhe riintegrimi për personat e radikalizuar ende mbetet për t'u zhvilluar për të plotësuar kornizën ligjore. Nëpër gjithë fushën në fjalë ekziston një pështjellim qasjesh ndaj riradikalizimit, por që nuk rrjedhin nga një proces konsultativ e i bashkërenduar.

Gjetjet kryesore:

- Sipas Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë, personat e dënuar duhet të i nënshtrohen programeve rehabilituese perpara rikthimit të tyre në shoqëri. Riintegrimi si i tillë nuk është politikë e preferuar, por detyrim ligjor për Qeverinë e Kosovës;
- Sikurse me vendet e tjera të rajonit, Kosovës i mungojnë kapacitetet për hartimin dhe zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegrimin brenda shërbimeve korrektuese;
- Që nga viti 2016, Qeveria e Kosovës e ka filluar procesin e hartimit të programit për deradikalizim dhe riintegrim. Zbatimi i tij pritet të fillojë gjatë vitit 2017;
- Programet e deradikalizimit dhe riintegrimin nuk iu drejtohen vetëm personave të kthyer nga zonat e luftës. Këto programe gjithashtu duhet të përfshijnë edhe personat që nuk iu janë bashkuar konflikteve të huaja, por kanë qenë subjekte të ekstremizmit brenda vendit;
- Shumica e ish-luftëtarëve të huaj të arrestuar nuk pritet të qëndrojnë në burg mbi 3.5 vjet;
- Ka dëshmi se të akuzuarit për terrorizëm dhe rekrutim po e vazhdojnë aktivitetin duke përhapur ideologji të dhunshme edhe brenda burgjeve. Shërbimet korrektuese nuk duken mjaftueshëm të për ta trajtuar këtë sfidë;
- Në fund të vitit 2016, janë ndërmarrë disa masa parandaluese nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, duke bërë vlerësime të rrezikut për çdo individ dhe duke kategorizuar ata sipas shkallës së radikalizimit;

- Literatura radikale fetare që ka hyrë në burgje me mjete të pazakonta është hequr nga autoritetet e Shërbimit Korrektues, ndërsa në dispozicion të të burgosurve janë vënë libra të rinjë me përmbajtje joprovokative. Kjo është kryer në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës;
- Kthimi i luftëtarëve të huaj në shoqëri ende mbetet sfida, meqë komuniteti i përgjithshëm në Kosovë shpreh rezerva kur është fjala për pranimin e tyre si pjesë e shoqërisë;
- Sondazhi i Barometrit Kosovar të Sigurisë evidentoi se shumica e të anketuarve mendojnë që LH-të duhet t'i nënshtrohen një programi rehabilitimi para riintegrit të tyre në shoqëri;
- Një pjesë e respondentëve treguan se janë të gatshëm t'i pranojnë luftëtarët e huaj në komunitetin e tyre, vetëm nëse ata mbikqyren nga autoritetet e sigurisë në Kosovë;
- Hulumtimi gjen se një model kosovar që përvetëson, përshtat dhe plotëson praktikën ekzistuese në Gjermani, Danimarkë dhe Arabi Saudite do ta ofronte një qasje që i përgjigjet nevojave të brendshme të Kosovës. Megjithatë, programi mund të përfitojë edhe nga modele të tjera.

HYRJE

Sikurse me vendet e tjera, Kosova po përballet me kërcënime nga ekstremizmi i dhunshëm, kthimi i luftëtarëve të huaj dhe individët e radikalizuar. Aktualisht Kosova ka rreth 130 individë (luftëtarë të huaj ose antarë të familjeve të tyre) dhe shumica prej tyre janë në nevojë për t'iu nënshtruar një procesi të deradikalizimit, veçanërisht atij të riintegrit. Programet e deradikalizimit dhe riintegrit nuk duhet të iu drejohen vetëm individëve që janë kthyer nga zonat e konfliktit. Këto programe gjithashtu përfshijnë edhe individët e tjerë që nuk ju kanë bashkangjitur konflikteve të huaja, por janë të radikalizuar dhe kanë kryer vepra të ekstremizmit të dhunshëm. Përveç kësaj programet e tilla duhet të përfshijnë edhe individët që kanë qenë të radikalizuar nëpërmjet mjeteve të shërbimeve korrektuese përmes të burgosurve tjerë. Në përpjekjet e fundit të trajtimit të ekstremizmit të dhunshëm, disa shtete evropiane si Gjermania, Britania e Madhe, Danimarka, etj, kanë filluar të përshtasin lloj-lloj qasjesh që synojnë ta trajtojnë çështjen, sidomos atë të luftëtarëve që kthehen nga zonat e konfliktit. Rehabilitimi gjithnjë e më shumë shihet si recetë politikash për të trajtuar ekstremizmin dhe për të ndaluar përhapjen e ideologjive të dhunshme. Rehabilitimi mund të përshkruhet si “ndërhyrje e qëllimshme e planifikuar që synon t’i ndryshojë karakteristikat e shkelësit të cilat besohen të jenë shkak i sjelljes kriminale të individit me synimin që ta reduktojë mundësinë që individit të ribëjë krimin.”¹ Deradikalizimi dhe riintegrimi i personave të radikalizuar është një nga objektivat kryesore si përgjigje e dështimit për të identifikuar dhe parandaluar ekstremizmin e dhunshëm.

Riintegrimi në shoqëri i ish-luftëtarëve të huaj ose individëve të lidhur me ideologji/ grupe të dhunshme ekstremiste është i vështirë, është një proces që kërkon kohë dhe burime. Ndikimi i tij ndryshon nga shteti në shtet, në varësi të shumë faktorëve të veçantë që duhen shqyrtuar me kujdes për të pasur zbatim të suksesshëm. Disa nga këta faktorë përfshijnë: ndryshimet sociale e ekonomike, arsimimin, ideologjinë, bindjet personale dhe kulturën politike të shtetit.

Seksioni i pare i këtij hulumtimi fillon me një pasqyrë të shkurtër historike të LEDh në Kosovë, duke vazhduar me analizimin e rëndësisë së programeve të rehabilitimit dhe riintegrit për LH e kthyer. Ky hulumtim vazhdon me një analizë të tri rasteve të studiuara: Gjermanisë, Danimarkës dhe Arabisë Saudite.

1 Tinka Veldhuis, “Designing rehabilitation and Reintegration Programs for Violent Extremist Offenders: A Realist Approach”. International Center for Counterterrorism. Hagë. f.3

Ky raport thekson faktin se, ndonëse diçka e re për Kosovën, riintegrimi i ish-luftëtarëve të huaj dhe individëve të tjerë të radikalizuar paraqet sfida që duhet adresuar si duhet nga shërbimet e saj korrektuese dhe akterët e tjerë relevantë. Në të vërtetë, programi i rehabilitimit për LH-të e kthyer² duhet të synohet shumë më qartë nga politikat. Në trajtimin e kësaj çështjeje, kur është fjala që Kosova t'a zhvillojë programin e vet të rehabilitimit dhe të riintegrimin, raporti propozon se mund të përdoret një përzierje më e larmishme e masave të forta dhe të buta.

2 Përfshirë këtu gratë dhe fëmijët që mund të konsiderohen viktime të familjarëve të tyre të radikalizuar

METODOLOGJIA

Metodat e analizimit të përdorura për këtë hulumtim janë: metodat cilësore dhe sasore, me një komponentë të madh të analizës krahasuese. Në kuadër të metodave cilësore, intervistat zënë një vend të veçantë. Këto intervista vijuan për një periudhë pesëmuajshe, ndërmjet tetorit 2016 dhe shkurtit 2017.

Metoda e parë është aplikuar për të mbledhur sa më shumë informacion veç e veç për luftëtarët e huaj të kthyer në shtëpi. Gjithsej, 9 intervista janë kryer me përfaqësuesit e palëve të interesuara si: Përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës, Përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Kosovë, Qendrës së Shërbimit Korrektues (QShK), Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe analistë të lartë në Këshillin e Sigurisë Kombëtare. QKSS shfrytëzon po ashtu të dhëna nga më se dhjetra intervista me luftëtarët e huaj të kryera për studime të tjera.

Për më tej, pjesë e rëndësishme e metodologjisë është analiza krahasuese e vendeve që ofrojnë programe mbi riintegrimin e ish-luftëtarëve të huaj të kthyer. Përderisa metodat sasore korrespondojnë në statistikat e luftëtarëve të huaj të cilët ju kanë bashkangjitur konflikteve të huaja dhe atyre të kthyer në shtëpi dhe me vullnetin e komunitetit në pranimin e luftëtarëve të huaj në shoqëri.

Vendimi për t'i krahasuar rastet e zgjedhura të studiuara, pra Gjermaninë, Danimarkën dhe Arabinë Saudite, qëndron në përzierjen e masave të buta dhe të forta që ato i aplikojnë kundrejt të kthyerve të tyre. Për shembull, Gjermania ka filluar të zbatojë programe rehabilitimi brenda burgjeve. Këto programe përfshijnë anëtarët e familjeve të të kthyerve si dhe trajnerë e psikologë. Danimarka ka programin "EXIT", i cili merret me radikalizimin duke u fokusuar më shumë në procesin e risocializimit sesa duke u bazuar në masa shtrënguese. Ky program fokusohet në burgje me ligjërata dhe trajnime, ku organizojnë seminare të ndryshme mes të burgosurve (p.sh. ndërtim, aftësi profesionale dhe arsimim të mëtutjeshëm). Arabia Saudite është vendi i dytë me më së shumti luftëtarë të huaj me përvojë konflikti. Sauditët ofrojnë riedukim islam në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm. Ata që konsiderohen ekstremistë të dhunshëm u nënshtrohen disa kurseve të cilat, ndryshe nga dy programet e paraprahe, kryesisht përqendrohen në riedukimin fetar dhe reinterpretimin e fesë.

Ky hulumtim ka disa kufizime që duhet theksuar. Ky kufizim konsiston në fazën e shkëputjes gjat riintegrimin të luftëtarëve të huaj. Vlen të përmendet se edhe pse faza e shkëputjes është parakusht që të zhvillohet çfarëdo procesi i rehabilitimit ose riintegrimin, raporti nuk do të përqendrohet në këtë fazë, pasi kjo lidhet me përpjekjet e policimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe sjelljes së të dyshuarit në gjykatë.

1. KONTEKSTI HISTORIK I LEDH NË KOSOVË

Konfliktet e vazhdueshme në Siri dhe Irak dhe zgjerimi i të ashtuquajturit “Shtet Islamik”³, në këtë punim i referuar si ISIS, tërhoqi numër të lartë të luftëtarëve të huaj, të cilët iu bashkuan ekstremistëve dhe njërive terroriste në konflikt. Të dhënat e përgjithshme nga hulumtime të ndryshme tregojnë se masat e forta që janë ndërmarrë në nivel ndërkombëtar nuk kanë pasur ndikim të jashtëzakonshëm në uljen e ritmit të LH. Përkundrazi, bazuar në të dhënat e mbledhura më 2016 nga Soufan Group, “pavarësisht përpjekjeve të qëndrueshme ndërkombëtare, për të përmbysur shtetin islamik dhe për të penguar rrjedhën e militantëve që udhëtojnë për në Siri, numri i LH është më shumë se dyfishi”⁴. Kjo nënkupton që ndikimi i këtyre përpjekjeve për të ulur ritmin e LH ka dështuar. Kjo tregon që duhet të ndërmerren masa të tjera për të ndaluar ritmin e LH për të shkuar në Siri dhe Irak. Në anën tjetër pas sulmeve të forta kundër ISIS-it, trendi për të shkuar në Siri është zvogëluar dukshëm në shtetet amë të LH.

Kosova nuk përbën përjashtim këtu. Në mars 2015, Parlamenti i Kosovës miratoi një projektligj për “ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit”⁵, si një reagim ndaj numrit relativisht të lartë të kosovarëve që i qenë bashkuar zonave të konfliktit në Lindjen e Mesme. Ka një numër të konsiderueshëm njerëzish që janë rekrutuar nga përkrahësit e ekstremistëve të dhunshëm si luftëtarët e huaj që kanë marrë pjesë të paktën një herë në konfliktet në Siri e Irak, kryesisht gjatë viteve 2012 e 2013. Mbi 40 gra nga Kosova i janë bashkuar grupeve të dhunshme ekstremiste në konfliktet në Irak dhe Siri⁶ ose ish Jabat al-Nusra-s që së fundmi e ka ndryshuar emrin në “Jabhat Fatah Al-Sham” pas ndërprerjes së lidhjeve me Al-Kaidën⁷.

Prej rreth 317 kosovarëve gjithsej (nga 2013 deri më 2015), që kanë marrë pjesë në konfliktet në Siri e Irak, rreth 127 konsiderohen të kthyer në Kosovë. Shumica dërmuese prej rreth 120 të këtyre tashmë janë arrestuar nga Policia e Kosovës, ndërsa

3 Shteti Islamik i vetëshpallur është lëvizje militante sunite që ka pushtuar territore në Irakun perëndimor, Sirine lindore dhe Libi nga i cili është munduar të krijojë kalifat, duke pretenduar autoritetin ekskluziv politik dhe teologjik mbi myslimanët e botës. Më 2014 sukseset e shpallura nga fushëbetejat tërhoqën mijëra të rekrutuar të huaj.

4 International Policy Digest: “How many foreign fighters in Syria are there?” October, 2016. Gjetet në: <https://intpolicydigest.org/2016/10/15/how-many-foreign-fighters-in-syria-are-there/>

5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. No.7/02. April, 2015. Prishtinë. Gjetet në: https://www.mpb-ks.org/repository/docs/LAW_NO_05_L_002_ON_PROHIBITION_OF_JOINING_THE_ARMED_CONFLICTS_OUTSIDE_STATE_TERRITORYEMLJE.pdf

6 QKSS: “Woman in violent extremism. Lessons learned from Kosovo”, shkurt 2017. Gjetet në: http://www.qkss.org/repository/docs/women-in-ve-eng_594236.pdf

7 Gjetet në: <http://www.al-monitor.com/pulse/originals/2016/08/jabhat-al-nusra-sever-al-qaeda-focus-local-syria.html>

58 raportohet të jenë vrarë në fushëbetejë në Siri e Irak.⁸ Sipas Gjykatës Themelore në Prishtinë, 59 të pandehur janë në arrati, që do me thënë se shumica e tyre janë në Siri e Irak.⁹ Këta janë individë të arrestuar më 2014 që u akuzuan në bazë të dispozitave të Kodit Penal të Kosovës. Të tjerët u arrestuan në bazë të ligjit të ri Nr: 05/L-002 për ndalimin për t'iu bashkuar konfliktit të armatosur jashtë territorit të vendit dhe për t'iu përfshirë në organizata terroriste, i cili hyri në fuqi në prill të 2015.¹⁰

Asnjë incident terrorist nuk ka ndodhur në Kosovë ndërsa është shkruar ky raport, por ka pasur raportime se Policia e Kosovës ka ndërmarrë një sërë veprimesh parandaluese duke arrestuar disa persona për planifikim të sulmeve. Vitin e kaluar, Policia e Kosovës arrestoi 19 persona të akuzuar për terrorizëm, të cilët pandehej (sipas policisë) se ishin përfshirë në planifikimin e një sulmi në Shqipëri gjatë ndeshjes ndërkombëtare të futbollit Shqipëri-Izrael që po zhvillohej në Shkodër.¹¹ Kjo tregon një arritje të jashtëzakonshme të strukturave të policisë dhe intelegjencës për të ndaluar sulmet e dyshuara terroriste.

Kur është fjala për trajtimin e luftëtarëve të huaj të kthyer, Qeveria e Kosovës ka treguar gatishmëri për programe të tilla, por duhet marrë parasysh lloji i qasjes që komuniteti zbaton në Kosovë kundrejt ish-luftëtarëve të huaj. Është me rëndësi të theksohet fakti se pjesa më e madhe e Kosovës ndjehej e pasigurt rreth luftëtarëve të huaj tashmë të kthyer në Kosovë. Gjetjet nga Barometri Kosovar i Sigurisë 2016¹² tregojnë se qytetarët kanë shprehur shqetësime për rreziqet që vijnë nga këta individë. Në BKS, qytetarët janë pyetur nëse luftëtarët e huaj të kthyer paraqesin ndonjë rrezik, dhe 64% e të anketuarve kanë deklaruar se ardhja e tyre përbën një kërcënim për sigurinë kombëtare. Prandaj qytetarët ngurrojnë t'i mirëpresin të kthyerit duke pasur parasysh kërcënimin që përbëjnë ndaj komunitetit dhe shtetit.

8 QKSS: "Mapping the state of play of institutional and community involvement in countering violent extremism in Kosovo". February 2017. Gjetet në: http://www.qkss.org/repository/docs/KCSS_Needs_Assesment_final_42754.pdf

9 Gjykata Themelore e Prishtinës, "Numbers of the defendants for Terrorism", nëntor 2016

10 LAW No. 05/L-002 ON Prohibition OF Joining THE Armed Conflicts Outside State Territory. Gjetet në: https://www.mpb-ks.org/repository/docs/LAW_NO_05_L_002_ON_PROHIBITION_OF_JOINING_THE_ARMED_CONFLICTS_OUTSIDE_STATE_TERRITORYEMLJE.pdf

11 Koha.net. Gjetet në: <http://koha.net/?id=27&l=142814>

12 Barometri Kosovar i Sigurisë, botimi i gjashtë. Gjetet në: http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-Sixth-Edition_327922.pdf

2. RËNDËSIA E PROGRAMEVE TË REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT NË LUFTIMIN DHE PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Rehabilitimi është proces i rëndësishëm që synon të ofrojë përkrahje për njerëzit që duhet të shkëputen nga veprimtaritë dhe idetë e dhunshme ekstremiste. Si term, rehabilitimi në këtë raport kuptohet si një përpjekje e bërë në kontekstin social për t'i angazhuar, risocializuar dhe mobilizuar në nivel bashkësie njerëzit e prekur nga një ideologji e ekstremizmit të dhunshëm. Kjo përfshin ata që kanë qenë pjesë e zonave të konfliktit në Siri e Irak dhe ata që janë brenda ose jashtë burgut. Programet rehabilituese dhe riintegruese duhet të zhvillohen për të dy rastet. Të dyja proceset, si dhe më shumë raste tjera (që nuk janë [rezente këtu), rehabilitimi dhe riintegrimi, duhet të marrin parasysh jo vetëm përjashtimin e tanishëm të individëve të prekur nga komuniteti, por edhe se si këta individë mund të jenë përsëri anëtarë përbërës të saj. Gjatë procesit të rehabilitimit, duhen ndërmarrë masa të ndryshme me qëllim të shkëputjes së individëve nga idetë dhe aktivitetet e dhunshme ekstremiste, p.sh. dhënia e ndihmës ekonomike për ata në nevojë, e edukimit social si dhe fetar, por edhe e terapisë psikologjike. Në anën tjetër hulumtime të ndryshme tregojnë përmirësimi i statusit socio-ekonomik dhe edukativ jo gjithmonë i pengon këta individë nga lidhja e ekstremizmit të dhunshëm. Bazuar në studimet e bëra nga "Mercy Corps", gjetjet tregojnë që ngritja e qasjes në statusin socio-ekonomik dhe atë të edukimit nuk e adreson plotësisht shtytësit potencial për vepra destabilizuese.¹³ Megjithatë, kombinimi i edukimit dhe përfshirjes aktive të qytetarëve që lejojnë rininë për të mbajtur fushata për komunitetin ulë dukshëm shkallën e mështetjes së dhunës.¹⁴

Për të kuptuar më mire ose për të gjetur qasje më të mire të de-radikalizmit dhe për të shkëputur individët nga ide të tilla, është e rëndësishme të studiojmë procesin se si ata kanë arritur në pikën e përçafimit të ideve të ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj, një strategji më e arsyeshme do të kërkonte tri faza kryesore të cilat do të përfshijnë: rehabilitimin, risocializimin dhe fazën e pas kujdesit. Siç tregojnë disa raste, shkëputja nuk është një proces i thjeshtë, dhe me masa shtërguese siç janë arrestimet dhe vendimet e burgosjes kanë impact kontradiktore në radikalizim. Mësimet tilla mund të marrim nga rasti i Irakut, ku pavarësisht nga bindjet e individëve të dyshuar, ata mbeten aktiv në aktivitetet ekstremiste të dhunshme dhe shpesh bëhen më të radikalizuar pas përfundimit të dënimit.¹⁵

Ngjajshëm, mundësia e radikalizmit të mëtutjeshëm dhe përhapja e tij brenda burgjeve duhet të merret në konsideratë edhe në Kosovë, dhe duhet të jetë shqetësimi kryesor për

13 Mercy Corps: "Critical choices: Assessing the effects of education and civic engagement on Somali youths' prosperity towards violence". November 2016.

14 Po aty

15 Shih këtu: http://www.huffingtonpost.com/kathy-kelly/abu-bakr-al-baghdadi-iraq-prison-camp_b_5851708.html

autoritetet e burgjeve. Raportohet se Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK), me përkrahjen e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) dhe Ministrisë së Drejtësisë kanë audituar literaturën në bibliotekat e disponueshme nëpër burgjet e Kosovës.¹⁶ Kjo sepse autoritetet kanë identifikuar libra që mund të konsiderohen që i përkasin interpretimeve të doktrinës së papranueshme të gjykuar nga autoritetet. Si rezultat, ata i kanë larguar nga raftet në mënyrë që të mund të parandalojnë radikalizimin e mundshëm brenda burgjeve të Kosovës. Megjithatë, duhet me qenë të vetëdijshëm se përhapja e ideve radikale ndodh kryesisht gjatë bisedave mes të burgosurve dhe si përgjigje ndaj kushteve që rrethojnë të burgosur të ndryshëm. Ato nuk shtyten vetëm nga përfshirja kritike a radikale me tekstet. Logjikisht, mund të besohet se radikalizmi vjen para leximit dhe jo anasjelltas. Gjetjet tregojnë se tashmë ka disa luftëtarë të kthyer të huaj në Kosovë që kanë pranuar të kenë tentuar qëllimisht të ndikojnë të të burgosurit e tjerë për ta pranuar “mënyrën e tyre” për ta praktikuar Islamin.¹⁷ Një tjetër aspekt i rëndësishëm që duhet marrë parasysh këtu është se vetë rezultati, kur lexohen tekste që mund të përmbajnë interpretime radikale, mund të jetë i ndryshëm në varësi të faktit nëse një individ është i radikalizuar ose jo. Prandaj, është e dyshimtë që të bëhet një lidhje e drejtpërdrejtë midis teksteve dhe radikalizmit, mbasi çdo interpretim është subjektiv. Veç kësaj, stafi profesional që merret me çështje të tilla nëpër burgje është i kufizuar.¹⁸

Kapitulli në vijim fokusohet në rastet specifike që janë të zgjedhura nga QKSS për të ilustruar modelet që Kosova mund të i përcjellë në përpjekjet e saj për të ofruar rehabilitim dhe riintegrim për personat e radikalizuar.

Meqë Kosova nuk ka përvojë me trajtimin e luftëtarëve të huaj të kthyer, sidomos me programet që synojnë rehabilitimin dhe riintegrimin, ky dokument përshat disa praktika dhe përvoja që i kanë përvetësuar disa shtete. Ky raport analizon modelet e tri rasteve të studiuara: Gjermanisë, Danimarkës dhe Arabisë Saudite. Arsyeja pse janë shqyrtuar këto raste është sepse të trija përdorin masa të ndryshme lidhur me programet e rehabilitimit e të riintegrimin, dhe kanë pasur rezultate të suksesshme. Gjermania ka përvojë të mëparshme në marrjen me rehabilitimin e neonazistëve (ekstremi i djathtë) dhe përdor masa të buta dhe të forta kundrejt luftëtarëve të kthyer nga zonat e konfliktit. Rasti i Danimarkës tregon se programi i rehabilitimit të personave të dënuar për ekstremizëm të dhunshëm arrin sukses duke përdorë masa të buta, sikurse dëshmohet nga koncepti i saj i “Qendrave të Rehabilitimit”, të cilat ndryshojnë nga burgjet klasike. Në përgjithësi, vendet skandinave janë të njohura për qasjen e butë kundrejt të burgosurve dhe përqendrimit në sistemin e rehabilitimit të të burgosurve. Nga ana tjetër, Arabia Saudite paraqet një rast që zbaton masa të buta fuqiplota ndonëse ka një koncept shumë klasik të sistemit të burgjeve. Ajo ka përvojë me këto programe që nga viti 2004 dhe është vendi i dytë më i madh me luftëtarë të huaj.

Tani i kthehemi analizimit të të trija rasteve studimore, dhe përqendrohemi në përbërësit e qasjeve përkatëse që janë përdorur në këto raste.

16 Intervistë me Sabri Bajgora. 15 Tetor 2016

17 Intervistë me Përfaqësues nga Qendrea e Shërbimit Korrektues. 06 Shkurt 2017

18 Po aty

2.1. Rast studimor: Gjermania

Gjermania është vend evropian që ka zhvilluar disa reforma që synojnë të riintegrojnë në shoqëri individë që lidhen drejtpërdrejt me ekstremizmin e dhunshëm. Në shkurt të 2014 autoritetet gjermane kanë identifikuar ideologjinë ekstremiste islame si kërcënim serioz. Ato kanë vlerësuar që numri i luftëtarëve të huaj gjermanë në Siri të jetë rreth 720.¹⁹ Autoritetet gjermane mbështeten në ndihmën e butë dhe në masat e forta të sigurisë, kur është fjala për parandalimin dhe luftën kundër radikalizimit të dhunshëm dhe marrjen me luftëtarët e huaj të kthyer. Nga ana e sigurisë, autoritetet kanë zgjedhur t'ua konfiskojnë pasaportat dhe dokumentet e tjera personale (letërnjoftimet) që t'ua vështirësojnë udhëtimin potencial, në mënyrë që të bëhen të pavlefshme jashtë Gjermanisë.²⁰ Por këto masa administrative nuk janë aplikuar me konsistencë. Sipas një raporti të intelegjencës gjermane që u lansua në dhjetor të vitit 2015, në total prej 677 shtetasve gjerman kanë shkuar në Siri dhe Irak që nga viti 2012. (raporti ka analizuar vetëm kohën kur ata kanë lënë shtetin e tyre deri më 29 Qershor 2015; vlerësimi i fundit zyrtar ka nxjerrur numrin e të shkuarve në 790). Mesatarisht, LH të deklaruar në raport kanë qenë të moshës 26 vjeçarë dhe fillimisht janë radikalizuar në moshën 22 vjeçarë. Më shumë se $\frac{3}{4}$ ishin meshkuj.²¹

Strategjia gjermane trajton radikalizimin përmes programit HAYAT²², program ky i shoqërisë civile që synon t'i deradikalizojë dhe riintegrojë ish-luftëtarët e huaj.²³ Financuar nga Zyra Federale Gjermane pëe migracion dhe refugjatë, qëllimi i HAYAT-it, që nga gjuha arabe do të thotë "Jetë"-për të parandaluar individët e radikalizuar musliman që të bëhen luftëtarë të huaj. HAYAT-i Lufton punën e rrjetit global të Xhihadit që taktikisht shfrytëzojnë rrjetet sociale për të shpërndarë propaganda dhe të rekutojnë anëtarë të rinjë.

Hapi i parë në procesin e HAYAT është që të kryhet një analizë dhe vlerësim rreziku për situatën përkatëse për të përcaktuar nëse rastet përbëjnë kërcënim dhe për ta kontrolluar nivelin e religjiozitetit.²⁴

19 ICCT: "The Foreign Fighters Phenomenon in the European Union: Profiles, threats, policies", prill, 20016, Hagë. Gjetet në: https://www.icct.nl/wp-content/uploads/2016/03/ICCT-Report_Foreign-Fighters-Phenomenon-in-the-EU_1-April-2016_including-AnnexesLinks.pdf

20 Journal Deradicalization: "Of alienation, association, and adventure: Why German fighters join ISIL?" pranverë 2016.

21 Po aty

22 HAYAT është i pari program gjerman këshillimi për personat e përfshirë në grupe radikale ose në rrugë drejt ekstremizmit të dhunshëm. Ky program është në dispozicion edhe për personat të radikalizuar.

23 Shih këtu: <http://hayat-deutschland.de/english/>

24 Yermi Brenner, "How Germany Is Attempting To De-radicalize Muslim Extremists", nëntor 3, 2016. Gjetet në: <http://forward.com/articles/212268/how-germany-is-attempting-to-de-radicalize-muslim/>

Modeli HAYAT përqendrohet në tri pika kryesore në procesin e deradikalizimit, i cili inkurajon riintegrim gradual në shoqëri. Këto përfshijnë aspektin:

1. ideologjik: të delegitimohen dhe zhvlerësohen narrativat e grupeve xhihadiste dhe të inkurajohen LH-të për t'u përballë me të kaluarën e vet;
2. pragmatik: të ndihmohen LH-të me gjetjen e punësimit, të edukimit ose trajnimit e akomodimit;
3. emocional: të adresohen nevojat emocionale të LH-ve për t'u përkrahur nga familjet e tyre dhe të krijohet një grup alternativ i referencës.²⁵

Iniciativat nën HAYAT bazohen në metoda dhe qasje të avancuara ndaj këshillimit dhe punojnë me të afërmit e të radikalizuarve që përfundimisht të parandalojnë, zbusin dhe përmbysin procesin e radikalizimit. Për më tej, programi HAYAT punon direkt me persona të radikalizuar për t'u treguar mundësitë e distancimit nga sjelljet radikale, dhe ideologjitë që konsiderohen kërcënim për shoqërinë. Shumica e iniciativave në Gjermani janë marrë në nivel shtetëror (Länder). Për shembull, në Landin e Hessen-it, Ministri i Brendshëm ka propozuar një model për t'i dalluar tendencat radikale islamike duke bërë që autoritetet t'i vizitojnë shkollat për t'i shpjeguar implikimet negative të udhëtimeve për në Siri. Këto modele kërkojnë të zbatojnë një sistem paralajmërimi të hershëm për t'i parandaluar individët, veçmas adoleshentët gjermanë, që të shkojnë në Siri. Gjithashtu, po krijojnë një linjë telefonike dhe qendra konsultimi për prindërit.²⁶

Është me rëndësi të theksohet se në projektet e rehabilitimit dhe riintegrimit brenda burgjeve në Gjermani, mbizotërues është theksi mbi sekularizmin. Gjermania ka zgjedhur një opSION laik për procesin e rehabilitimit në vend se të përfshijnë imamë dhe autoritete të tjera fetare, ngjashëm me vendet e tjera europiane, përfshirë Danimarkën dhe Arabinë Saudite jashtë Europës.²⁷ Imamëve nuk u lejohen të marrin pjesë në projektet HAYAT, që më parë përqipen të deradikalizojnë përmes mjeteve jofetare. Modeli gjerman për deradikalizimin dhe riintegrimin bazohet në përvojën me ekstremistët e djathtë neonazistë në vitin 1990.²⁸ Kjo mund të shpjegojë qasjen më laike ndaj rehabilitimit të luftëtarëve të huaj.

Kuptohet, rezultati i programeve rehabilituese dhe riintegruese vështirë mund të vlerësohet. Sipas një këshilltari në HAYAT, ky program ka trajtuar 130 raste deri tani.²⁹

25 Charles Lister, "Returning Foreign Fighters: Criminalization or Reintegration", Foreign Policy Brookings, 2015. P.10

26 Benjamin Weinthal, "The German jihadist's colony in Syria", *The long War Journal*, December 19, 2013

27 Shih këtu: <http://www.dw.com/en/germany-neglecting-islamist-de-radicalisation-in-prisons/a-19141684>

28 Yermi Brenner: "How Germany is attempting to de-radicalize muslims extremists". January 16, 2015. Gjendet në: <http://forward.com/articles/212268/how-germany-is-attempting-to-de-radicalize-muslim/>

29 Po aty

Rezultatet e vlerësimit tregojnë sukses në kuptimin që riburgosja e rasteve ka treguar normë ndjeshëm më të ulur.³⁰

Rrëfimi i suksesit mbrapa këtyre programeve qëndron në ndihmën e dhënë për familjet e individëve. Këto programe u ofrojnë atyre përkrahje dhe ndihmë të veçantë individëve të prekur nga ekstremizmi i dhunshëm, si arsimimi dhe ndihma psikologjike. Nga ana tjetër, ndikimi i neglizhencës së autoriteteve fetare për të debatuar me individë të radikalizuar fetarisht, dhe mundësia e kësaj që të ketë ndikim pozitiv në deradikalizim, ende mbetet për t'u parë. Autoritetet gjermane ia lënë çështjen në duar familjes me arsyetimin se islamistët vlerësojnë rolin e fuqisë së nënës në familje. Megjithatë, vrotimet dhe disa intervista nga terreni në rastin e Kosovës tregojnë se shumë nga ata që kanë shkuar për t'u bashkuar me konfliktet në Lindjen e Mesme i kanë gënjyer (të dy) prindërit lidhur me destinacionin, ose duke shpërfillur nevojën fetare për të marrë leje nga nëna para se t'i bashkohen xhihadit, kështu duke minuar mundësitë e suksesit të modelit gjerman për familjen. Raporti tani kalon në dy rastet e tjera të studiuara.

2.2. Rast studimor: Danimarka

Danimarka është njëri nga vendet që ka zhvilluar një program të veçantë për proceset e rehabilitimit dhe të riintegritimit. Danimarka njihet për përdorimin e masave të buta ndaj ish-luftëtarëve të huaj (dhe ekstremistëve të dhunshëm përgjithësisht). Autoritetet daneze kanë identifikuar ideologjinë ekstremiste islame si kërcënim serioz për sigurinë shtetërore.³¹ Më 2016, 125 danezë udhëtuan për luftë me grupet ekstremiste në Siri e Irak. Përafërsisht 62 janë kthyer. 4 prej tyre janë arrestuar nga policia pasi ishin kthyer në kryeqytetin danez.³² Pas kthimit në Danimarkë, të kthyerit kontrollohen nga policia, dhe pastaj marrin ndihmën e Shërbimit të Sigurisë dhe Inteligjencës Daneze.³³ Qasja e danezëve ka qenë duke rehabilituar më shume se 15 ish LH që janë rikthyer në Danimarkë nga Siria.³⁴ Që nga shtatori 2014, autoritetet daneze kanë rehabilituar shumicën e 15 ish-luftëtarëve të huaj

30 American Institute for Contemporary German Studies: "Countering Jihadist Prison Radicalization in Germany and U.S". Gjetet në: <http://www.aicgs.org/publication/countering-jihadi-prison-radicalization-in-germany-and-the-u-s/>

31 CSS Study; "Foreign Fighters: An overview of responses in eleven countries". March 2014. Available at: http://www.css.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/center-for-securities-studies/pdfs/Foreign_Fighters_2014.pdf

32 Denmark: Extremism-Counter extremism. Gjetet në: http://www.counterextremism.com/sites/default/files/country_pdf/DK-04222016.pdf

33 Shërbimi PET shërben si autoriteti i sigurisë dhe inteligjencës kombëtare. PET është përgjegjës për identifikimin, parandalimin, hetimin dhe luftimin e kërcënimeve ndaj lirisë, demokracisë dhe sigurisë në shoqërinë daneze.

34 Danish Institute for International Studies: "An introduction to Danish approach to countering and preventing violent extremism and radicalisation". 2015. Gjetet në: <http://www.ft.dk/samling/20151/almdel/reu/bilag/248/1617692.pdf>

që kanë rihyrë në Danimarkë nga Siria.³⁵ Sipas profesorit të psikologjisë në Universitetin Aarhus të Danimarkës, relevant në këtë fushë, Preben Breteslen, “një qytetari të shtetit demokratik të rregulluar me ligj duhet t’i jepet mundësia për rehabilitim dhe përfshirje në shoqëri”.³⁶ Me fjalë të tjera, individët e tillë kanë të drejtë të ‘ridrejtohen’ larg trajektores së mëparshme drejt aktiviteteve më legjitime.

Programet e Danimarkës bazohen në dialogun që synon ta gjejë rrugën për të parandaluar pjesëmarrjen në zonat e konfliktit. Autoritetet daneze përqendrohen kryesisht në qendrat e rehabilitimit që merren me të rinjtë. Në vend të kërcënimit me arrestim dhe burgosje të të rinjve që duan të bashkohen me grupet ekstremiste dhe të të kthyerve nga zonat e luftës në Lindjen e Mesme, autoritetet daneze ofrojnë disa programe riintegrimit dhe rehabilitimi, duke përfshirë: kujdesin shëndetësor, shkollimin, gjetjen e punës, dhe asistencë me akomodim. Ky model së fundi është quajtur Aarhus model.³⁷ Modeli Aarhus përbëhet nga një varg i gjerë faktorësh që kanë ndikim të madh në riintegrimin e personave të radikalizuar, si p.sh. Shtëpia Informative e cila përfshin raste me probleme sociale dhe psikologjike.³⁸ Rrjeti i prindërve është një tjetër faktor i rëndësishëm që lehtëson dialogun mes autoriteteve lokale dhe familjeve të atyre që preken nga ekstremizmi i dhunshëm. Rrjeti i prindërve është themeluar për prindërit që duhet të merren me fëmijët e radikalizuar, dhe synon t’i fuqizojë këta prindër kur merren me fëmijë të radikalizuar.³⁹

Danimarka i ka dhënë prioritet strategjisë për rehabilitimin dhe riintegrimin e LH të kthyer nëpërmjet dy programeve themelore: Programit të Parandalimit të Hershëm (PPH), i cili synon ta parandalojë radikalizimin e dhunshëm të mëtejme të të rinjve që nuk shfaqin ndonjë rrezik ose kërcënim të sigurisë, por munden nëse procesi i radikalizimit të vazhdon në drejtim të dhunshëm⁴⁰, dhe inkurajon të tjerët që të kthehen nëpërmjet Programit Exit. Në Danimarkë, policia, këshilli komunal dhe OJQ-të lokale bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe janë angazhuar gjerësisht me komunitetet muslimane për ta parandaluar radikalizimin.⁴¹ Përveç parandalimit, ky model përfshin Programin Exit për ata që tashmë janë radikalizuar. Programi Exit drejtohet ndaj

35 Denmark: Extremism-Counter extremism. Gjetet në: http://www.counterextremism.com/sites/default/files/country_pdf/DK-04222016.pdf

36 Charles Lister, “Returning Foreign Fighters: Criminalization or Reintegration”, Foreign Policy Brookings, 2015. P.7-8

37 Aarhus Model comprises programs for both early prevention and exit processes. It tries to prevent further violent radicalization and deals with radicalized individuals.

38 Panorama, “From the Desert to World Cities, the New Terrorism”, Konrad Adenauer Stiftung, January, 2015 P.243-245.

39 Po aty

40 Preben Bertelsen, “Danish Preventive Measures and De-radicalization Strategies: The Aarhus Model”. January 2015. Gjetet në: http://psy.au.dk/fileadmin/Psykologi/Forskning/Preben_Bertelsen/Avisartikler_radikalisering/Panorama.pdf

41 Charles Lister, “Returning Foreign Fighters: Criminalization or Reintegration”, Foreign Policy Brookings, 2015. P.9

njerëzve tashmë të radikalizuar që kanë qëllime dhe aftësi për të kryer krime të dhunshme dhe terrorizëm të motivuar politikisht dhe fetarisht.⁴²

Iniciativa e Programit Exit ofron trajtim mjekësor për plagët e luftës dhe traumat psikologjike. Ky program i ndihmon edhe luftëtarët e kthyer që të gjejnë punë dhe ta vazhdojnë arsimin.⁴³

Një tjetër element i rëndësishëm është dialogu që zhvillohet me komunitetet muslimane. Ky faktor është përjashtuar nga modeli gjerman në deradikalizim. Ekipi Aarhus është në dialog të vazhdueshëm të hapur me komunitetet e ndryshme, organizatat dhe xhamitë në Aarhus me qëllim që ta parandalojë radikalizimin e dhunshëm të pjesëtarëve të tyre të rinj, duke përfshirë rekrutimin nga ekstremistët e dhunshëm. Arsimi konsiderohet si një aktivitet tjetër shumë i rëndësishëm në kuadër të këtij modeli që përfshin rrjetin e lehtësuesve, mentorëve, trajnimin gjithëpërfshirës dhe punëtoritë me instruktorë në procesin e deradikalizimit, rreziqet dhe rreziqet e mundshme, si dhe menaxhimin e konflikteve.⁴⁴

Ky model përdor edhe metoda si policimi në komunitet, komunikimi midis mësuesve, këshilltarëve, prindërve, anëtarëve të tjerë të komunitetit dhe policisë.⁴⁵ Për më tej, me anë të këtij programi autoritetet mbajnë kontakt me familjet e atyre që tashmë janë në Siri, që nga ndihma që të mbeten në kontakt me mjete të ndryshme komunikimi të lidhjet me zyrtarët e qeverisë, konsullatat dhe agjencitë e inteligjencës për t'u ndihmuar që t'i kthejnë të afërmit në shtëpi, kur të vendosin se duan të kthehen.⁴⁶ Për siguri, ky program nuk përpiket t'ua ndryshojë ideologjinë ekstremistëve të dhunshëm. Sipas rehabilituesit Steffen Nielsen: "Nuk shpenzojmë shumë energji duke i luftuar ideologjitë".⁴⁷ Ai e arsyeton këtë duke argumentuar se nuk duan t'i bëjnë ta ndryshojnë ëndrrën e tyre për "Kalifatin", sepse ka mjete që nuk mund t'i përdorin për shkak të kufizimeve të ofruara nga kodi penal në Danimarkë.⁴⁸ Kjo qasje i lejon individët të jenë çka duan të jenë, sa kohë që nuk bëjnë gjëra që kundërshtojnë ligjin. Me fjalë të tjera, kjo nuk përqëndrohet në atë që njerëzit mendojnë, sa kohë që veprimet që mund t'i ndërmarrin nuk janë të paligjshme.

42 Po aty

43 Denmark Counter Extremism Project. 2016.

44 Po aty

45 Kelly Cobiella, "Denmark De-radicalization Program Aims To Reintegrate Not Condemn" maj 2015. Gjetendet në: <http://www.nbcnews.com/storyline/isis-terror/denmark-de-radicalization-n355346>

46 Al Jazeera: "Denmark introduces rehab for Syrian fighters". Shtator 2014. Gjetendet në: <http://www.aljazeera.com/indepth/features/2014/09/denmark-introduces-rehab-syrian-fighters-201496125229948625.html>

47 Po aty

48 Po aty

Sipas autoriteteve daneze që merren me këto programe, numri i njerëzve që udhëtojnë nga Aarhus për të luftuar në Siri ka rënë nga 31 më 2013 në vetëm një më 2014.⁴⁹ Përpjekjet e forta dhe bashkërendimi mes Autoritetit Kombëtar të Inteligjencës dhe Sigurisë (PET) me udhëheqësit fetarë është treguar shembull i mirë për t'u marrë me ish-luftëtarët e huaj. Në rastin e Danimarkës, kjo konsiderohet qasje pozitive për eliminimin e ekstremizmit të dhunshëm.⁵⁰ Pas përpjekjeve të koordinuara nga PET për të iniciuar një dialog me liderët fetar, statistikatat nuk treguan ndonjë tendencë nga danezët për të iu bashkangjitur Xihadit në Siri.⁵¹ Modeli danez i riintegrimit ka tërhequr vëmendjen botërore për qasjen e butë ndaj ish-luftëtarëve të huaj. Megjithatë, duhet theksuar se Danimarka, nga ana tjetër, u ofron sasi të madhe parash këtyre programeve që të jenë të suksesshme. Si e tillë, kostoja e këtyre programeve duhet marrë parasysh nëse Kosova vendos ta aplikojë një model të tillë.

2.3. Rast studimor: Arabia Saudite

Arabia Saudite mund të jetë njëri nga vendet e fundit ku do të prisnim të gjenim një kurs terapie arti për terroristët e dënuar. Mbretëria, njihet për qasje të pafalshme në drejtësinë penale.⁵² Megjithatë, në të njëjtën kohë sauditët drejtojnë programet efektive për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm brenda kufijve të vet pasi që shumë herë ekstremistët e dhunshëm kanë pretenduar dhe here-herë kanë ndermarrë veprime për ta përmbysur Mbretërinë që e akuzojnë si apostate për bashkëpunim me Perëndimin.

Programet e deradikalizimit dhe rehabilitimit në Arabinë Saudite kanë filluar më 2004, gjatë të cilës kohë ka spikatur qasja e butë. Ka deri ka rreth 2,500 luftëtarë të huaj të nisur nga Arabia Saudite për t'u bashkuar me konfliktin e fundit, duke e renditur si vendin e dytë në krye të listës me luftëtarë të huaj.⁵³ Me kalimin e kohës, programi saudit i rehabilitimit u rrit në fushëveprim dhe prestigj, mbasi një pjesë e madhe e ish-luftëtarëve të huaj dukej se po riintegroheshin me sukses në shoqëri. Sauditët ofrojnë riedukim islamik që trajton çështjen e ekstremizmit të dhunshëm. Ata që konsiderohen ekstremistë të dhunshëm u nënshtrohen disa kurseve që synojnë t'u ua ndryshojnë idetë nëpërmjet interpretimeve alternative ose të kryerrymës fetare saudite.⁵⁴ Programi i

49 Kelly Cobeilla: "Denmark De-radicalization program aims to reintegrate not condemn", maj 2015. Gjendet në: <http://www.nbcnews.com/storyline/isis-terror/denmark-de-radicalization-n355346>

50 Hudson Institute: "The Danish Model for Prevention of Radicalisation and Extremism". August 2014. Available at: <https://www.hudson.org/research/10555-the-danish-model-for-prevention-of-radicalisation-and-extremism>

51 Po aty

52 Bennet Drake: "How to defuse a human bomb". Prill, 2008.

53 The Telegraph: "Iraq and Syria: How many foreign fighters are fighting for Isis?", mars, 2016. Gjendet në: <http://www.telegraph.co.uk/news/2016/03/29/iraq-and-syria-how-many-foreign-fighters-are-fighting-for-isis/>

54 Abdullah F, Ansary, "Combating Extremism: A brief overview of Saudi Arabia's approach". Middle East Policy.

rehabilitimit fillon me të burgosurit dhe është projektuar ta trajtojë të burgosurin si viktimë të keqpërdorur që mund të shpëtohet me riedukim.⁵⁵

“Programi i Arabisë Saudite është projektuar me supozimin se ekstremizmi i dhunshëm vjen si rezultat i një interpretimi të gabuar të Islamit, para se si mbështetje e qëllimshme për terrorizmin. Kështu, programet janë dizajnuar për të ‘riedukuar’ individë dhe promovuar një interpretim më tërësor dhe të padhunshëm të fesë”⁵⁶

Pikë e rëndësishme e programit saudit është se ai filloi vetëm me përfshirjen e klerikëve, por me kalimin e kohës, klerikët kuptuan se një qasje thjesht ideologjike (në këtë rast islame) nuk ishte e mjaftueshme. Për rrjedhojë, ftuan profesionistë psikiatër dhe psikologë për të ndihmuar me vlerësimin e të burgosurve në të gjithë programin e trajtimit dhe në vitet e fundit kanë shumë aspekte psikologjike të programit të tyre, duke përfshirë këtu terapi arti.⁵⁷

Përbërësit kryesorë të strategjisë së Arabisë Saudite janë ndarë në tri mjete: parandalim, rehabilitim dhe përkujdesje e mëtejshme.⁵⁸ Këto tri mjete synojnë t’i shkurajojnë individët nga të prekurit prej terrorizmit ose ideve të dhunshme ekstremiste.

Parandalimi synon të shkëpusë ideologjinë e përqaftuar nga individët e shënjestruar nga ekstremizmi t’i mësojë viktimat e mundshme me shprehjen dhe interpretimet jo të dhunshme dhe ligjore të Islamit. Parandalimi i rekrutimit të një brezi të ri ekstremistësh të dhunshëm është detyra kryesore gjatë kësaj faze. Kjo fazë përfundon me disa programe këshillimi, të quajtura programe parandaluese dhe kurative, të cilat përfshijnë leksione publike, punëtori, seminare dhe konferenca përveç shfrytëzimit të mjeteve të komunikimit masiv, duke përfshirë TV, gazeta dhe internetin për t’iu kundërvënë ideologjive devijuese.⁵⁹ Këto programe shërbejnë si programe këshilluese, që drejtohen me sesione dialogu me familjet dhe individët në shtëpitë e tyre. Këta studiues takohen me udhëheqësit e fiseve dhe nxënësit në shkolla dhe shkojnë në xhami për të dhënë leksione. Ata shpenzojnë rreth 15 ditë në një zonë për ta rritur vetëdijesimin për rreziqet e ekstremizmit. Ministria e Brendshme organizon edhe ngjarje si bisedime në mbrëmje dhe leksione, duke diskutuar aspekteve të ndryshme të radikalizimit.⁶⁰

55 Po aty

56 Fink&Hearne, “Beyond Terrorism: De-radicalization and Disengagement from Violent Extremism”. Tetor 2008. f. 6

57 Bennet Drake: “How to defuse a human bomb”. Prill, 2008

58 Christopher Boucek, “Saudi Arabia’s Soft Counterterrorism Strategy: Prevention, Rehabilitation and Aftercare”. Carnegie endowment for international peace, Shtator 22, 2008.

59 Po aty

60 Po aty

Rehabilitimi dhe parakujdesi i Strategjisë saudite të Rehabilitimit synon të riedukojë individëve përmes dialogut intensiv dhe debateve fetare. Para se t'i kthehen shoqërisë, viktimat kalojnë një periudhë prej tetë deri në dymbëdhjetë javë në Qendrën për këshillim. Procesi i këshillimit fillon me takim sy më sy midis një të burgosuri (viktimit) dhe një komiteti këshillimor. Kjo inkurajon ekstremistët që të heqin dorë nga "ideologjitë terroriste";⁶¹ veçanërisht doktrina e Tekfirit.⁶² Programi këshillimor është projektuar jo për dënim a ndëshkim por në prezumimin të dashamirisë.

Aspekt i rëndësishëm i Programit saudit të Rehabilitimit është se nuk përbëhet vetëm nga ligjëratat fetare. Dialogjet dhe diskutimet po ashtu inkurajohen. Brenda burgjeve ka hapësira për familjet, që të akomodohen vizitorë dhe ta lehtësojnë përfshirjen e familjeve të të burgosurve, ndërsa krijojnë rrjete më të mëdha sociale, të cilat lehtësojnë procesin e rehabilitimit.⁶³

Ndryshe nga programi gjerman i riintegrit që përjashton autoritetet fetare, Arabia Saudite përfshin dijetarë islamë që shërbejnë si ligjërues në burg – çka përshtatet me traditat specifike dhe rrethanat e vendit. Qëllimi i klerikëve është t'u shpjegojnë të burgosurve pse justifikimet e tyre për t'u përfshirë në praktika të dhunshme ishin të gabuara, dhe t'u mësojnë mbi interpretimet e miratuara të Islamit prej shtetit.⁶⁴ Ky program drejton një varg sesionesh të shkurtra dialogu që zgjasin një deri në dy orë e që mbahen në seanca klasash dhe takimesh formale dhe joformale. Këto programe sesionesh të shkurtra përbëhen nga kurse gjashtëjavëshe në tema të veçanta, si ideologjia tekfir, xhihadi dhe terrorizmi. Pas kësaj, çdo i burgosur hyn në provim që duhet ta kalojë ose ta rimarrë nëse duhet.⁶⁵

Programi i rehabilitimit i nisur nga Ministria e Brendshme e Arabisë Saudite përqendrohet më shumë në sistemin e burgjeve. Studiues të ndryshëm fetarë vizitojnë burgjet, ku kalojnë kohë duke folur me të burgosurit. Nëse të burgosurit me sukses i transformojnë sistemet e veta të besimit, atëherë këta individë kalojnë nëpër Qendrën e Kujdesit të Rehabilitimit (QKR).⁶⁶ QKR ofron përkahje për anëtarët e familjes me aftësi të kufizuara dhe ata me nevojë për ndihmë psikologjike.⁶⁷ Kjo qendër ka shumë aktivitete që konsiderohen të rëndësishme në procesin e kundër-radikalizimit, sepse jo

61 Christopher Boucek, "Saudi Arabia's Soft Counterterrorism Strategy: Prevention, Rehabilitation and Aftercare". Carnegie endowment for international peace, September 22, 2008.

62 Takfir is referred to someone who is unbeliever and no longer Muslim.

63 Global Research Analysis, Christopher Boucek "Jailing Jihadists: Saudi Arabia's Special Terrorist Prisons Publication: Terrorism Monitor Volume: 6 Issue: 2. January 2008. Gjetend në: <https://jamestown.org/program/jailing-jihadis-saudi-arabias-special-terrorist-prisons/>

64 ChristooharBoucek, "Extremist Reeducation and Rehabilitation in Saudi Arabia". August, 2016

65 Po aty

66 Po aty

67 Marc Jones: "Rehabilitating Islamist Extremists: Successful methods in Prison-Centred 'De-Radicalisation' Programmes".

vetëm ndërtojnë punë ekipore, por edhe nxisin e i zhvillojnë institucionet shtetërore. Ky është programi më i gjatë dhe më i plotë në kuadër të rehabilitimit që ofron qendra.

Ndër elementet kyçe të Programit saudit të Rehabilitimit është se nuk e trajton vetëm individin, por përfshin dhe familjen e të burgosurve.⁶⁸ Për më tej, informon komunitetin lidhur me situatën në burg. Ky është një mekanizëm i mirë reciprociteti mes dy palëve dhe rrit bashkëpunimin mes të burgosurve dhe anëtarëve të familjes. Ky program i detyron familjet edhe të kujdesen për anëtarët e familjes pas një lirimi nga burgu.

Që nga fillimi i këtij programi në vitin 2004, sipas Dr. Muhammad Al Nujaymi nga Komiteti për Këshillim rreth 2000 të burgosur kanë marrë pjesë duke kaluar nëpër faza të ndryshme përmes këtyre programeve të këshillimit. 700 prej tyre kanë i kanë shpallur besimet të ndryshuara.⁶⁹ Megjithatë, sipas disa raporteve të publikuara rreth 1,400 prej tyre kanë refuzuar të jenë pjesë e programeve rehabilituese, sepse shumica e këtyre të burgosurve nuk besojnë kurrë se do të dalin nga burgu dhe prandaj qëllimisht përpiqen t'i hedhin poshtë përpjekjet e autoriteteve për t'i ndihmuar të burgosurit.⁷⁰

Arabia Saudite ka qenë deri diku e suksesshme dhe në disa raste ka arritur të pengojë individë nga përçafimi i ideve të dhunshme ekstremiste, por edhe që t'i deradikalizojë ata që tashmë i kanë përçafuar këto ide. Duke pasur parasysh kontekstin e vendit, janë përqendruar jashtëzakonisht në riedukimin fetar me që këto programe punonin nën supozimin se idetë e dhunshme ekstremiste brenda Arabisë Saudite kryesisht rezultojnë prej keqkuptimeve fetare. Si e tillë shteti e thekson mbizotërimin e kurrikulave fetare në të gjitha fazat e arsimit. Edhe pse Arabia Saudite i ka zbatuar këto programe specifike për kontekstin e tyre që jo detyrimisht mund të jetë po aq produktive në kontekste të tjera, të paktën, mund të nxirren disa elemente të veçanta që mund t'u përshtaten rasteve të tjera.⁷¹

Megjithatë, sikurse me Danimarkën, duhet të theksohet se programi për rehabilitim në Arabinë Saudite gëzon avantazhin e shumës së burimeve dhe parave të ofruara për këtë program.

68 Samuel J. Mullins: "Rehabilitation of Islamists Terrorists: lessons from criminology". University of Wollongong. 2010.

69 Po aty

70 Po aty

71 Shënim për lexuesit: Diskutimi këtu pranon raporte që flasin për mundësinë e përfshirjes së Arabisë Saudite në mbështetjen e grupeve të dhunshme ekstremiste jashtë territorit të vendit. Ky hulumtim, megjithatë, sugjeron se kjo nuk duhet të ngatërrohet me programet që ky vend drejton për të parandaluar dhe për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm brenda kufijve të vet, diçka që regjimi e ka luftuar për dekada të tëra. Raporte të ngjashme dhe literatura akademike sugjerojnë se mbështetja për grupet e dhunshme ekstremiste ka qenë edhe pjesë e mjeteve të politikës së jashtme të shumë vende perëndimore. Po kështu, mjete të tilla të politikës së jashtme nuk duhen ngatërruar me objektivat e vërtetë që këto vende kanë dhe duan t'i posedojnë së brendshmi - kështu mund të nxirren mësimë në përpjekjet vendore të tyre.

3. A MUND TA KRIJOJMË NJË MODEL KOSOVAR PËR T'U MARRË ME LH-TË?

Një model i mundshëm, të cilin Kosova do të duhej ta miratonte, do të merrte parasysh disa nga përvojat dhe praktikat e vendeve të elaboruara më lart, të përshtatura për kontekstin e Kosovës.

Pavarësisht nga mungesa e përvojës me ish-luftëtarë të huaj, Qeveria e Kosovës ka shfaqur gatishmëri për ta hartuar një programi rehabilitimi dhe riintegrimi për individët e prekur nga ekstremizmi i dhunshëm. Ministria e Drejtësisë me mbështetjen e ICITAP-it ka filluar ta zbatojë një program rehabilitimi dhe riintegrimi krahas shërbimit korrektues. Ky program ndahet në tri faza (rehabilitim brenda burgjeve, riintegrim social dhe lirim i mëpasëm pas fazës së përkujdesjes). Ky program përfshin disa përbërës, e ndër ta trajnim të stafit të përfshirë, intervista me të burgosurit, vizitat familjare si dhe aktivitete brenda burgjeve.⁷²

Luftëtarët e huaj të kthyer nuk janë grup homogjen, personat tjerë të radikalizuar gjithashtu. Për të qenë efektivë, programet e riintegritit duhet të jetë fleksibile ndaj karakteristikave dhe nevojave specifike të individëve. Çdo përpjekje për të riintegruar ekstremistë të dhunshëm ose terroristë duhet të fillojë me vlerësimin e nevojave të individit, duke përdorë metoda të veçanta vlerësimi të rrezikut për ekstremizmin e dhunshëm.

Përveç disa aspekteve të modeleve të zbatuara nga tri rastet e studiuara që u diskutuan më lart, propozimi i QKSS-së për një model bazohet edhe në hulumtimet e kryera në terren. Ekipi hulumtues i QKSS ka identifikuar 3 kategori individësh të shënjestruar të cilat duhet t'i ketë parasysh një program i Kosovës për rehabilitimin dhe riintegrimin: a) të kthyerin me vullnet vetjak që nuk tregojnë pendesë për ç'kanë bërë; b) familjet e personave të prekur nga ekstremizmi i dhunshëm; dhe c) Ata që nuk kanë qenë pjesë e konfliktit, por kanë kryer aktivitete kriminale të ndërlidhura me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Me këto kategori në mendje dhe duke përfituar nga disa aspekte të modeleve në rastet e studiuara që u diskutuan, modeli i Kosovës duhet të përbëhet nga tri faza të veçanta: 1) faza e rehabilitimit; 2) faza e riintegritit; 3) faza e pas-lirimit. Një analizë më e thellë se si secila prej këtyre fazave duhet të punojnë është dhënë më poshtë.

72 Intervistë me Mike Pannek. 10 Shkurt 2017.

3.1. Faza e rehabilitimit

Qëllimi i rehabilitimit është që ta nxisë procesin e ripërfshirjes shoqërore të shkelësit që kërkon një shpërndarje nga qëndrimet dhe sjelljet e tyre të mëparshme. Rehabilitimi shërben si një mjet i vlefshëm për ta ndryshuar rrethin e dhunës për ata që nuk shohin ndonjë mundësi tjetër për ta bërë këtë pa ndihmën e jashtme. Gjatë kësaj faze, është gjithashtu e mundur të mësohen më shumë mësimet mbi motivet e ndryshme të luftëtarëve të huaj. Gjatë intervistimit të LH nga hulumtues të QKSS-së është vërejtur se jo të gjithë tregojnë gatishmëri dhe vullnet të i nënshtrohen procesit të rehabilitimit.⁷³ Individë të tillë janë më të irrituar karshi institucioneve dhe nuk mendojnë që shteti mund të bëjë më të mirën për ta.⁷⁴ Kjo fazë është esenciale dhe pjesë e pashkëputshme e qasjes gjithpërfshirëse jo vetëm për LH por edhe për të burgosurit tjerë. Kjo fazë duhet të përbëhet nga disa komponentë që kanë rëndësi për trajtimin e personave të radikalizuar si:

Qendrat korrektuese ose rehabilitimi brenda burgjeve – programe rehabilitimit në shumë vende hasin në vështirësi se si më së miri t'i adresojnë të burgosurit dhe taktikat e rekrutimit të tyre. Nevojat e rehabilitimit për të burgosurit ndryshojnë, varësisht nga profili i tyre i vetë procesit të radikalizimit. Së fundi, QSHK ka bërë përpjekje të përmirësojë qendrat e shërbimit korrektues duke përfshirë kamera mbikqyrëse brenda burgjeve dhe duke bërë vlerësimin e rrezikut.⁷⁵ Sipas një përfaqësuesi të Qendrës së Shërbimit Korrektues (QShK), të burgosurit e Kosovës janë përqendruar në disa nga qendrat e shërbimeve korrektuese dhe ndarë në dy kategori: ata me shkallë të lartë të radikalizimit janë të vendosur në "Burgun e Sigurisë së Lartë" në Dyz, ku 18 të burgosur të akuzuar për ekstremizëm të dhunshëm janë të shpallur fajtorë. Ndërsa, të burgosurit më pak të radikalizuar mbahen në qendra paraburgimi në Dubravë, Lipjan, Smrekonicë, Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë, dhe Lipjan.⁷⁶

Këta persona janë të përzier me të burgosur të tjerë, të dënuar për krime të tjera.⁷⁷ Ideja themelore prapa rehabilitimit nëpërmjet burgimit është se një person një herë i burgosur kurrë nuk do të dojë të kthehet në burg, pasi të jetë liruar.⁷⁸ Në anën tjetër, shumë hulumtime argumentojnë se disa të burgosur do të mësojnë mënyra të reja dhe më të mira për të kryer krime, ndërsa janë të burgosur.⁷⁹ Prandaj, burgjet nuk janë mjet i garantuar për rehabilitim. Shërbime më të mira rehabilituese duhet t'u ofrohen të burgosurve, siç janë aktivitetet brenda dhe jashtë burgjeve. Për shembull, krijimi i një mjedisi më të mirë përmes aktiviteteve sportive, palestrës, lejimi i qasjes

73 Intervistë me H.L. 20 Shkurt 2017

74 Po aty

75 Intervistë me përfaqësues nga Qendra e Shërbimit Korrektues, 06 Shkurt 2017

76 Po aty

77 Shih këtu: <http://zeri.info/aktuale/95442/rrezik-nga-radikalizmi-neper-burgje/>

78 Shih këtu: <http://www.crimemuseum.org/crime-library/rehabilitative-effects-of-imprisonment/>

79 Po aty

në libra nga fusha të ndryshme jofetare si dhe të praktikojnë ritmet fetare gjithashtu. Megjithatë, janë disa sfida që mund të bëjnë procesin e rehabilitimit të vështirë si pasojë e mungesës së mjaftueshme të buxhetit dhe pasiqë çdo gjë është e lidhur me burgjet, ka mungesë të stafit profesional (ekspertëve brenda burgjeve).⁸⁰

Integrimi i familjeve në program janë një tjetër komponent i rëndësishëm. Është me rëndësi të përmendet se, programet e rehabilitimit dhe riintegrimit nuk duhen përqendruar veç në individë të radikalizuar (ish-luftëtarë të huaj), por një pjesë e këtyre programeve duhet t'i përfshijë edhe familjet e tyre dhe persona të tjerë jashtë burgjeve që mund të jenë subjekt potencial i radikalizimit. Familja luan rol jetik në LEDh dhe promovimin e suksesshëm të rasteve studimore. Rilidhja me familjen pasi një LH i mundshëm të kthehet në shtëpi është hapi i parë që do të lehtësonte ose të bënte të mundshëm riintegrimin e tyre të ardhshëm. Familja është përbërës i rëndësishëm social në sjelljen e individit, dhe kjo është një nga elementet e "ndihmës së parë" në të cilën duhet përqendruar çdo program. Familja luan edhe rolin e ndërmjetësit mes personave të radikalizuar dhe shoqërisë – duke përfshirë institucionet publike, dhe si e tillë mund të sigurojë mbështetje të drejtpërdrejtë në të dy drejtimet. Megjithatë qeveria duhet të ofrojë mbështetje sociale për familjet e LH-ve (të radikalizuara të tjerë dhe rolin e nënave në de-radikalizim në përgjithësi) për të ndihmuar dhe për t'i inkurajuar që të jenë urë mes këtyre ish-luftëtarëve të huaj dhe autoriteteve shtetërore. Për të rikujtuar, rastet e Danimarkës, Gjermanisë dhe Arabisë Saudite sugjerojnë që përfshirja e familjeve dhe komunitetin në programin e rehabilitimit mund të jetë i suksesshëm, sidomos në Kosovë, ku familja dhe komuniteti luajnë rol shumë të madh. Përgatitja e familjeve me qasjet më të mira të mundshme, kur bashkëveprojmë me anëtarët e tyre të kthyer të familjes gjithashtu lehtëson procesin e risocializimit dhe integrimit. Perceptimi dhe sjellja e familjes ndaj të kthyerit mund të ketë njërin nga ndikimet e para dhe më të mëdha mbi të kthyerin.⁸¹ QKSS ka vizituar familjarët e luftëtarëve të huaj të angazhuar në ekstremizëm të dhunshëm në raste të shumta, dhe sipas tyre kemi identifikuar se ata mund të ndihmojnë me procesin e rehabilitimit. Brenda familjes, roli i nënës është i rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Njëri ish-luftëtarë e huaj të kthyer, Albert Berisha, na e tregoi përvojën e vet se si nëna e tij ndikoi në vendimin për t'u kthyer në shtëpi.⁸² Ai tha: "Ishte zëri i nënës sime që më bëri të mendoj të kthehem prapa në shtëpi".⁸³ Prandaj, familja duhet të konsiderohet faktor kyç në të gjitha fazat, atë të rehabilitimit, të risocializimit dhe fazën pas lirimit.

Trajtimi psikologjik është një tjetër përbërës që luan një rol të rëndësishëm në programin e rehabilitimit. Psikologët mund të na informojnë më shumë lidhur me faktorët socialë dhe psikologjikë, personalitetin e tyre, dhe ta propësojnë tjetërsimin si nxitës

80 Intervistë me Valdet Hoxha. 20 Shtator 2016

81 Intervistë me Liridon Berisha. 23 Tetor 2016

82 Intervistë me Albert Berisha. 23. Tetor 2016

83 Po aty

të ekstremizmit të dhunshëm. Ky informacion ndihmon të përcaktohet nëse janë kërcënim dhe të hartojnë plan riintegrimi më të individualizuara. Kujdesi psikologjik dhe mjekësor është i nevojshëm për të gjithë të kthyerit.

Autoritetet fetare (teologët): Autoritetet fetare kanë ndikim të caktuar mbi individët e radikalizuar fetarisht që aspektet e tjera të rehabilitimit nuk e kanë. Ata posedojnë autoritetin e interpretimit fetar përmes të cilit, ndonëse jo gjithmonë, individët e radikalizuar mund t'i justifikojnë veprimet. Një interpretim fetar jo i dhunshëm nga një autoritet fetar, i hartuar specifikisht për të synuar individë të radikalizuar, mund të jetë burim i një diskutimi më legjitim me viktimat. Ata kanë gjasë t'u njohin gjuhën, mentalitetin dhe mund të kontribuojnë në luftimin e ideologjisë së tyre, në rastet kur diskutimet e mirëfillta mund të bëhen mes disave nga këto autoritete fetare dhe individëve të radikalizuar fetarisht. Një analist nga Këshilli për Siguri Kombëtare thekson rolin e imamëve në procesin e rehabilitimit. Ai potencoi se imamët duhet të kenë një kurrikulë të veçantë lidhur me ligjëratat dhe debatet me të burgosurit.⁸⁴ Studimet e ndryshme nga rastet studimore në këtë hulumtim kanë treguar se këshillimi fetar mund të sjellë ndryshime pozitive qëndrimi dhe motivimi, ose mund t'i inkurajojë të burgosurit që t'i përmbahen një interpretimi më të moderuar paqësor të fesë. Në fund, është shteti ai që vendos se kush duhet të arrestohet.⁸⁵

Ish-luftëtarët të huaj për ekstremistët: luftëtarë të huaj të zhgënjyer mund të shërbejnë si mjete veçanërisht të fuqishme kundër ndikimit të propagandës së ekstremistëve. Ata individë që janë kthyer mund të përfshihen në riintegrimin e vetë procesit. Natyrisht, duhet pasur kujdes kur zgjedhjen për të qenë pjesë e procesit, pasi që ish-ekstremistët e dhunshëm mund të bëhen shënjestra për hakmarrje të dhunshme. Ish-luftëtarët e huaj që janë penduar për udhëtimin në zonat e konfliktit dinë më mirë rreth procesit të radikalizimit, dhe mund të kenë njëfarë legjitimiteti kur flasin me të sapokthyerit. Ata kanë edhe histori për të ndarë me njëri-tjetrin dhe duhet të përpunohen nëpër gjithë shoqërinë dhe institucionet publike. Autoritetet shtetërore duhet t'i inkurajojnë ish-LH-të dhe t'u japin mundësi të shprehin përvojat e pjesëmarrjes së tyre në konfliktet në Siri e Irak dhe pasojat negative të kësaj përfshirjeje. Shumë nga ish-luftëtarët e huaj që nuk konsiderohen të prekur me radikalizmin mund të kontribuojnë në kundërnarativën e LH-ve të tjerë. Një shembull është rasti i Albert Berishës, i cili ishte pjesë e konfliktit në Siri e Irak, dhe pas një viti vendosi të tregonte publikisht historinë se si vendimi për t'u bashkuar me konfliktin ishte i gabuar.⁸⁶

3.2. Faza e riintegrimit

Riintegrimi, ose siç njihet nga legjislati i Kosovës, faza e risocializimit, shpesh cilësohet si mbështetje e dhënë për shkelësit gjatë procesit të rihyrjes në shoqëri pas burgimit.

84 Intervistë me Kujtim Bytyqi. 15 Tetor 2016

85 Intervistë me Përfaqësues nga Qendra e Shërbimit Korrektues. 06 Shkurt 2016


86 Intervistë me Albert Berisha. 23 Tetor 2016

Edhe riintegrimi ose risocializimi është pjesë e kornizës ligjore të Kosovës që rregullon ekzekutimin e sanksioneve penale. Më saktë, *Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale* kërkon që sanksionet penale të ekzekutohen ashtu që të sigurohet trajtim njerëzor dhe respekt për dinjitetin e çdo individi të dënuar. Procesi i risocializimit dhe riintegritit të personit të dënuar në komunitet po ashtu duhet të ndjekë rrugën e përfshirjes së institucioneve private dhe publike, si dhe të individëve të tjerë që potencialisht mund të kontribuojnë në procesin e riintegritit.⁸⁷ Riintegrimi ose risocializimi është menduar të jetë një proces i cili u jep subjekteve ndjenjën e kthimit shpresëdhënëse për shoqërinë. Është e rëndësishme të theksohet se modeli i riintegritit ndjek disa parime të marra nga disa praktika prej rasteve të trajtuara më lart, por të përshtatura për kontekstin vendas. Kjo fazë përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

Komuniteti: shërben si një mekanizëm për t'i ndihmuar të kthyerit të rilidhen me shoqërinë dhe të mos ndjehen të izoluar. Ndërtimi i besimit mes anëtarëve të komunitetit dhe të kthyerve është i rëndësishëm nëse dhe kur kalojnë kohë në burg dhe pasi të jenë lëshuar. Margjinalizimi i plotë ose përjashtimi i këtyre individëve mund të çojë në zhgënjim të mëtejshëm dhe sjellje të papritur. Por, problemi mbetet se gatishmëria e komunitetit dhe vullneti për të riparuar ish LH në shoqëri nuk janë shumë premtuese, duke theksuar se punë të madhe duhet të bëhet në këtë nivel.

Më konkretisht, sipas Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS)⁸⁸ kur u pyetën nëse janë të gatshëm për të pranuar luftëtarë të huaj në bashkësinë e tyre, të anketuarit dhanë përgjigjet e mëposhtme:

Figura 1. A jeni gati personalisht për të pranuar ish-luftëtarë të huaj në bashkësinë tuaj?




87 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. "Ligji Nr. 04/L -149 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale". Gjetet në: [http://www.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_ekzekutimin_e_sanksioneve_penale_\(anglisht\).pdf](http://www.md-ks.net/repository/docs/Ligji_per_ekzekutimin_e_sanksioneve_penale_(anglisht).pdf)

88 Barometri Kosovar i Sigurisë, botimi i gjashtë. Gjetet në: http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-Sixth-Edition_327922.pdf

Gjetjet tregojnë se qytetarët ngurrojnë t'i pranojnë luftëtarët e huaj të Kosovës në komunitetin e tyre, për shkak të kërcënimit që ndiejnë se LH-të përbëjnë për komunitetin. Gjetjet e BKS tregojnë se 58% e të anketuarve nuk do të ndiheshin të sigurt të jetonin në të njëjtin komunitet me ish-luftëtarët e huaj. Në anën tjetër, një e katërta e të anketuarve thanë se janë të gatshëm t'i pranojnë luftëtarët e huaj përsëri në komunitet, vetëm nëse mbikëqyren nga autoritetet e sigurisë në Kosovë. Është herët të spekulohet për sfondin e përgjigjeve të tilla, por ai fillon të tregojë se çfarë ndiejnë njerëzit në lidhje me riintegrimin. Njëkohësisht, kjo ka një truk normativ, sepse nëse programi i riintegrit dëshmon ndonjë sukses, duhet bërë punë në nivelin e komunitetit për të shpjeguar nivelin aktual të kërcënimit që këta individë mund të paraqesin për komunitetin, ose të paktën heterogjenitetin në mesin e LH-ve të kthyer kur është fjala për nivelin e sigurisë që secilit prej tyre paraqet.

Gjithashtu, të pyetur lidhur me masat që duhet të ndërmerren shteti për LH-të e kthyer në Kosovë, të anketuarit e projektit BKS kishin perceptime të përziera. Rreth 54% e tyre thanë se LH-të duhet t'i nënshtrohen një programi rehabilitimi dhe risocializimi para riintegrit të tyre në shoqëri. Nga ana tjetër, 24% e të anketuarve thanë se LH-të e kthyer në Kosovë duhet të arrestohen menjëherë, pas kthimit të tyre këtu. Ndërsa 16% e të anketuarve kanë thënë se shteti duhet t'i ndalojë qytetarët e kthyer të Kosovës të cilët kanë marrë pjesë në konfliktet në Siri e Irak.

Figure 2. Çfarë mendoni në lidhje me kthimin e luftëtarëve të huaj në Kosovë?



Edukimi jo-formal: konsiderohet po ashtu element thelbësor i risocializimit dhe fazës së paslirimit, si dhe i çfarëdo mase parandaluese. I pengon që të kthehen në ish-rrjetin e tyre. Edukimi u ofron të rinjve një rrugë të rëndësishme nëpërmjet të cilës ata informohen mbi ide dhe mundësi të ndryshme. Trajnimi është edhe komponentë kritike e fazës së arsimimit. Trajnimi profesional shpesh ofrohet për karriera të veçanta ose tregti dhe fokusohet kryesisht në aplikimet praktike të aftësive të mësuara me

pak theks në teori. Kjo përmirëson aftësitë e punësimit dhe përgatit të burgosurit për tregun e punës pas liritimit nga burgu. Kështu, gjatë përfshirjes me institucione arsimore, investime të rëndësishme duhen vënë në cilësinë e arsimit. Shoqëria civile dhe qeveria duhen inkurajuar për të siguruar arsimim përmes trajnimeve dhe leksioneve për aftësitë e tyre. Arsimiti cilësor është komponent kyç në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, dhe kështu roli i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është vendimtar këtu.

Statusi socio-ekonomik: konsiderohet si një tipar i rëndësishëm për gati të gjitha fazat e deradikalizmit dhe riintegritimit. Meqë aspekti socio-ekonomik konsiderohet si njëri ndër faktorët shtytës që u mundëson individëve t'u bashkohen zonave të konfliktit në Siri dhe Irak, trajtimi i aspektit socio-ekonomik në praktikë duhet të jetë pjesë e procesit të gjerë. Megjithëse, ky është aspekt i përgjithshëm dhe afatgjatë i cili konsideron faktorë të tjerë socio-politikë në vend. Gjatë punës së QKSS në terren, është vërejtur që disa nga familjet të prekura nga ekstremizmi i dhunshëm jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike. Megjithatë, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, thuhet se ata nuk ndajnë ndonjë buxhet të caktuar jo për shkak të vullnetit, por për shkak të mungesës së buxhetit në përgjithësi.⁸⁹

3.3. Faza pas burgimit

Procesi i rehabilitimit nuk përfundon brenda mjedisit të burgjeve. Kjo është faza e fundit e një programi të rehabilitimit dhe riintegritimit. Kjo fazë duhet të konsiderohet si hapi i fundit para rihyrjes së subjekteve në shoqëri. Kthimi në shoqëri pas një numri vitesh nuk është i thjeshtë. Kjo fazë ka disa sfida, sepse është e vështirë të vlerësohet kur kanë përfunduar me sukses fazat e tjera. Megjithatë, në këtë fazë, individët e rehabilituar mund ta gëzojnë lirinë. Prandaj kjo fazë mund të shërbejë si mjet për monitorimin e lëvizjeve, veprimeve dhe sjelljeve të individëve të liruar nga burgjet. Gatishmëria është gjithmonë e vështirë të matet, edhe pse gjykimi duhet të bëhet bazuar në vullnetin dhe gatishmërinë e subjektit për t'u rikthyer në komunitet dhe për t'u angazhuar për një jetë normale. Megjithatë, vëmendje e veçantë duhet ende t'u kushtohet këtyre subjekte edhe pasi faza të ketë përfunduar. Punësimi, edukimi dhe mundësi të tjera duhen ofruar po ashtu.

Monitorimi nga policia: pas lëshimit, duhet t'u kushtohet vëmendje atyre që kanë dalë nga burgu. Roli i policisë është të mbikëqyrë dhe ta monitorojë sjelljen e të rikthyerve në komunitet. Përfshirja e policisë duhet të ofrojë sigurinë publike dhe ta promovojë zgjidhjen e problemeve. Në të njëjtën kohë, policia duhet të inkurajojë një rol bashkëpunues ndërmjet të burgosurve të liruar dhe komunitetit.⁹⁰

89 Intervistë me Fatmir Haxholli. 14 Shtator 2016

90 Intervistë me përfaqësues nga Qendra e Shërbimit Korrektues. 06. Shkurt 2017

4. PËRFUNDIM

Programet e deradikalizimit shihen si përgjigje e mundshme ndaj pyetjes se çfarë të bëjmë me numrin e madh të ekstremistëve radikal në mbarë botën. Kur bëhet fjalë për deradikalizimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe personave tjerë të radikalizuar, hulumtimi thekson që megjithatë mund të jetë e vështirë të aplikohen praktikat e huaja dhe të garrantohet sukcesi në implementimin e plot të tyre. Aktualisht Kosova është në proces të adresimit të programeve të rehabilitimit dhe riintegrit. Meqenëse riintegrimi është një praktikë relativisht e re në Kosovë, ofrimi i modeleve dhe praktikave nga vende të tjera paraqet opsione të mundshme se si Kosova duhet të merret me fenomenin e tillë.

Duke analizuar modele të tilla, QKSS ofron një program alternativ të ndarë në tri faza: 1. Fazën e rehabilitimit, që përfshin disa komponentë si rehabilitimi brenda burgjeve, integrimin e familjeve në këtë program, trajtimi psikologjik, autoritetet fetare, rëndësinë e ish-luftëtarëve të huaj për ekstremistat. 2. një fazë riintegrimi ose risocializimi, që përfshin komunitetin, edukimin jo formal, statusin socio-ekonomik, trajnimet; si dhe 3. fazën e paslirimit, që përmban punësim, arsim, dhe monitorim prej policisë. Një program i tillë do të ishte i dobishëm në kontekstin e Kosovës në të cilën QKSS ka përvojë me komponentët e ngjajshëm të secilës faze si dhe pritet që një qasje gjithëpërfshirëse riintegruese të mund të krijohet.

Ky hulumtim përfundon me vendosjen e komponenteve dhe karakteristikave të cilat do të mundësonin aplikimin e tyre në kontekstin e Kosovës. Programi i Kosovës adreson nevojat sociale të të burgosurve duke theksuar edhe rolin e familjes në këto përpjekje. Ofrimi i asistencës socio-ekonomike për familjet në nevojë do të parandalonte radikalizimin e mundshëm të anëtarëve të tjerë si dhe do të nxiste vullnetin e mirë të institucioneve dhe do ta rriste besimin në to.

Si i tillë, ky hulumtim ka përpiluar masa efektive për institucionet e Kosovës nga strategjitë e ndryshme kombëtare me shpresën që të merren parasysh këto masa dhe të sigurohet implementim më i mirë i mundshëm brenda modelit Kosovar.

BIBLIOGRAFIA

Dokumente zyrtare dhe botime nga e institucionet e Kosovës:

- Law on Prohibition of Joining the Armed Conflicts Outside State Territory. prill 2015. Prishtinë. Gjetet në: https://www.mpbks.org/repository/docs/LAW_NO_05_L_002_ON_PROHIBITION_OF_JOINING_THE_ARMED_CONFLICTS_OUTSIDE_STATE_TERRITORYEMLJE.pdf
- Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. "Law NO 04/L -149 on Execution of Penal Sanctions". gusht 2013. Prishtinë. Gjetet në: [http://www.mdks.net/repository/docs/Ligji_per_ekzekutimin_e_sanksioneve_penale_\(anglisht\).pdf](http://www.mdks.net/repository/docs/Ligji_per_ekzekutimin_e_sanksioneve_penale_(anglisht).pdf)
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit 2012-2017. qershor 2012. Prishtinë. Gjetet në: https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategy_for_Counter_Terrorism_2012_2017_eng.pdf
- Strategjia për parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që çon në 2015-2020. shtator 2015 Prishtinë. Gjetet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY_parandalim_-_ENG.pdf

Dokumente dhe publikime zyrtare ndërkombëtare:

- UNHCR, Country Reports on Terrorism 2015- Kosovo. Qershor 2016. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashuara. Gjetet në: <http://www.refworld.org/docid/57518dae1e.html>
- United Nations Global Counter-Terrorism Strategy. prill 2012. Gjetet në: <http://www.un.org/en/terrorism/ctitf/pdfs/A%2066%20762%20English.pdf>
- United States Department of State Publication: "Country Reports on Terrorism 2014". 2015. Gjetet në: <http://www.state.gov/documents/organization/239631.pdf>

Dokumente e publikime të tjera ndërkombëtare

- Alexandre Mello, Michael Knights: "The Cult of the Offensive: The Islamic State on Defense". prill 2015. Gjetet në: <https://www.ctc.usma.edu/v2/wp-content/uploads/2015/05/CTCSentinel-Vol8Issue43.pdf>
- Christopher Boucek: "Saudi Arabia's "Soft" Counterterrorism Strategy: Prevention, Rehabilitation, and Aftercare". shtator 2008.
- Counter Terrorism Project: "Denmark: Extremism & Counter-Extremism". 2015. http://www.counterextremism.com/sites/default/files/country_pdf/DK-04222016.pdf
- CSS STUDY: "Foreign Fighters: An Overview of Responses in Eleven Countries". March 2014. Gjetet në: http://www.css.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/center-for-security-studies/pdfs/Foreign_Fighters_2014.pdf
- European Network Based Prevention and Learning Program Parandalimi dhe Mësimi i bazuar në Rrjetin Evropian: "Inventory of the best practices on de-radicalization from the different Member States of the EU". 2013. Gjetet në: http://www.terra-net.eu/files/nice_to_know/20140722134422CVERLTdef.pdf
- Parlamenti Evropian: "Religious practice and observance in the EU Member States". 2013. Gjetet në: [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/2013/474399/IPOL-LIBE_ET\(2013\)474399_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/2013/474399/IPOL-LIBE_ET(2013)474399_EN.pdf)
- Qendra Globale për Siguri Bashkëpunuese, "Managing, Rehabilitating, and Reintegrating Violent Extremist Offenders". September 2014. Gjetet në: <http://www.globalcenter.org/ep-content/uploads/2014/10/19-Sept-2014-GCTF-Rehab-project-description.pdf>
- HAYAT Deutschland. "HAYAT-Germany Counseling | De-radicalization | Network. Gjetet në: <http://hayat-deutschland.de/english/>

- ICCT: "Designing Rehabilitation and Reintegration Programmes for Violent Extremist Offenders: A Realist Approach", mars 2012. Gjendet në: <https://ëëë.icct.nl/download/file/ICCT-Veldhuis-Designing-Rehabilitation-Reintegration-Programmes-March-2012.pdf>
- ICCT: "The Foreign Fighters Phenomenon in the European Union", prill 2016. Gjendet në: <https://www.icct.nl/download/file/ICCT-Veldhuis-Designing-Rehabilitation-Reintegration-Programmes-March-2012.pdf>
- Instituti Danez për Studime Ndërkombëtare "An introduction to Danish approach to countering and preventing violent extremism and radicalisation". 2015. Gjendet në: <http://www.ft.dk/samling/20151/almdel/reu/bilag/248/1617692.pdf>
- Hudson Institute: "The Danish Model for Prevention of Radicalisation and Extremism". August 2014. Gjendet në: <https://www.hudson.org/research/10555-the-danish-model-for-prevention-of-radicalisation-and-extremism>
- INTERNATIONAL PEACE INSTITUTE: "Beyond Terrorism: Deradicalization and Disengagement from Violent Extremism". tetor 2008. Gjendet në: <https://www.ipinst.org/wp-content/uploads/publications/beter.pdf>
- Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë: "Kosovo Security Barometer", botimi i gjashtë, dhjetor 2016. Gjendet në: http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-Sixth-Edition_327922.pdf
- QKSS: "Report inquiring into the causes and consequences of Kosovo citizens' involvement as foreign fighters in Syria and Iraq". prill 2015. Gjendet në: http://www.qkss.org/repository/docs/Report_inquiring_into_the_causes_and_consequences_of_Kosovo_citizens'_involvement_as_foreign_fighters_in_Syria_and_Iraq_307708.pdf
- QKSS: "Mapping the state of play of institutional and community involvement in countering violent extremism in Kosovo". February 2017. Gjendet në: http://www.qkss.org/repository/docs/KCSS_Needs_Assesment_final_42754.pdf
- QKSS: "Gratë në ekstremizmin e dhunshëm. Mësimet nga Kosova". Shkurt 2017. Gjendet në: http://www.qkss.org/repository/docs/women-in-ve-eng_594236.pdf
- Mohamed Bin Ali, Rohan Gunaratna: "Terrorist Rehabilitation: A New Frontier in Counter-terrorism". 2015.
- The Soufan Group. "FOREIGN FIGHTERS An Updated Assessment of the Flow of Foreign Fighters into Syria and Iraq", dhjetor 2015. Gjendet në: http://soufangroup.com/ëp-content/uploads/2015/12/TSG_ForeignFightersUpdate3.pdf
- Yermi Brenner, "How Germany Is Attempting to De-radicalize Muslim Extremists", November 3, 2016. Gjendet në: <http://forward.com/articles/212268/how-germany-is-attempting-to-de-radicalize-muslim/>
- Instituti Amerikan për Studime Gjermane Bashkëkohore: "Countering Jihadist Prison Radicalisation in Germany and U.S.". Gjendet në: <http://www.aicgs.org/publication/countering-jihadi-prison-radicalisation-in-germany-and-the-u-s/>
- Charles Lister, "Returning Foreign Fighters: Criminalization or Reintegration", Foreign Policy Brookings, 2015.
- Panorama, "From the Desert to World Cities, the New Terrorism", Konrad Adenauer Stiftung, January, 2015

Burime mediatike

- Indeksi Online: "Ekskluzive: Fakte se ekstremizmi fetar ka depërtuar në burgje, ja kush u radikalizua". nëntor 2016. Gjendet në: <http://indeksonline.net/lajmet/ekskluzive-fakte-se-ekstremizmi-fetar-ka-depertuar-ne-burgje-ja-kush-u-radikalizua-foto-30608/>
- International Policy Digest: "How Many Foreign Fighters In Syria Are There?" tetor 2016. Gjendet në: <https://intpolicydigest.org/2016/10/15/hoë-many-foreign-fighters-in-syria-are-there/>
- Mail online: "US Prison camp in Iraq accidentally formed ISIS by housing the most radial jihadists together and alloëing them to organize terror group". maj 2015. Gjendet në: <http://www.daily->

mail.co.uk/news/article-3104859/US-Prison-camp-Iraq-accidentally-formed-ISIS-housing-radial-jihadists-allowing-organize-terror-group.html

- NBC News: "Denmark De-radicalization Program Aims to Reintegrate, Not condemn". maj 2015. Gjendet në: <http://www.nbcnews.com/storyline/isis-terror/denmark-de-radicalisation-n355346>
- NY Times: "Don't Blame 'Wahhabism' for Terrorism". Gjendet në: http://www.nytimes.com/2016/10/20/opinion/dont-blame-wahhabism-for-terrorism.html?mwrsm=Facebook&_r=2
- The Local dk: "Denmark unveils neë anti-radicalization measures". tetor 2016. Gjendet në: <http://www.thelocal.dk/20161012/denmark-unveils-new-anti-radicalisation-measures>
- Zëri: "Rrezik nga radikalizmi nëpër burgje". qershor 2016. Gjendet në: <http://zeri.info/aktuale/95442/rrezik-nga-radikalizmi-neper-burgje/>

Intervista

- **Fatmir Haxholli**- këshilltar politik në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- **Kujtim Bytyqi**- Analist në Këshillin e Sigurimit Kombëtar
- **Mike Panek**- Këshilltar i Lartë në Qendrën Korrektuese - ICITAP
- **Valdet Hoxha**- Zëvendësministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Koordinator i Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm
- **Sabri Bajgora**- Kryeimam i Bashkësisë Islame të Kosovës
- **Përfaqësues** nga Qendra e Shërbimit Korrektues
- **Albert Berisha** - ish-luftëtar i huaj
- **Liridon Kabashi** - ish-luftëtar i huaj
- **H.L.** - ish-luftëtar i huaj
- **SH.T.** - ish-luftëtar i huaj

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351:327(496.51)(047)

Muji, Arife

Riintegrimi i luftëtarëve të huaj të rikthyer: Çfarë qasje i përshtatet më së miri Kosovës? / Arife Muji. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2017. – 36 f. ; 21 cm.

Bibliografia : f. 33-35

ISBN 978-9951-679-60-2

ISBN 978-9951-679-60-2



9 789951 679602

www.qkss.org